

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar  
Advanced Financial Reporting

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data  
13.01.2018

## CONTENT / PËRMBAJTJA

| Pjesa         | Maksimumi i Dhënë | -Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK</u> -PIKËT E DHËNA |
|---------------|-------------------|------------------------------------------------------------------------------|
| 1. Problemi 1 | 30                |                                                                              |
| 2. Problemi 2 | 10                |                                                                              |
| 3. Problemi 3 | 20                |                                                                              |
| 4. Problemi 4 | 20                |                                                                              |
| 5. Problemi 5 | 20                |                                                                              |
| <b>Total</b>  | <b>100</b>        |                                                                              |

## Problemi 1

Më poshtë janë dhënë pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 për Veriu sh.a, Lindja sh.a, Jugu sh.a and Perendimi sh.a.

### Pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

|                                       | <b>Veriu<br/>sh.a<br/>€'000</b> | <b>Lindja<br/>sh.a<br/>€'000</b> | <b>Jugu<br/>sh.a<br/>€'000</b> | <b>Perendimi<br/>sh.a<br/>ALL'000</b> |
|---------------------------------------|---------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|---------------------------------------|
| Shitjet                               | 67,000                          | 42,000                           | 15,000                         | 600                                   |
| Kosto e shitjeve:                     |                                 |                                  |                                |                                       |
| Stoqet në fillim                      | 10,000                          | 5,800                            | 3,200                          | 200                                   |
| Blerjet                               | 40,000                          | 20,000                           | 5,300                          | 600                                   |
| Stoqet në fund                        | <u>(15,000)</u>                 | <u>(9,000)</u>                   | <u>(2,000)</u>                 | <u>(536)</u>                          |
|                                       | <u>(35,000)</u>                 | <u>(16,800)</u>                  | <u>(6,500)</u>                 | <u>(264)</u>                          |
| Fitimi bruto                          | 32,000                          | 25,200                           | 8,500                          | 336                                   |
| Shpenzimet operative                  | (8,400)                         | (9,400)                          | (2,950)                        | (26)                                  |
| Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes |                                 |                                  |                                | (70)                                  |
| Te hyrat nga dividenda preferenciale  | 12                              |                                  |                                |                                       |
| Fitimi në shitjen e makinerisë        | <u>          </u>               | <u>          </u>                | <u>100</u>                     | <u>          </u>                     |
| Fitimi para tatimit                   | 23,612                          | 15,800                           | 5,650                          | 240                                   |
| Tatimi                                | <u>(5,903)</u>                  | <u>(3,950)</u>                   | <u>(1,412)</u>                 | <u>(60)</u>                           |
| <b>Fitimi pas tatimit</b>             | <b>17,709</b>                   | <b>11,850</b>                    | <b>4,238</b>                   | <b>180</b>                            |

### Informata shitesë:

- i) Kapitali i emetuar i paguar dhe levizjet tjera në ekuitet të të gjitha kompanive janë si në vijim:

|                                          | <b>Veriu<br/>sh.a<br/>€'000</b> | <b>Lindja<br/>sh.a<br/>€'000</b> | <b>Jugu<br/>sh.a<br/>€'000</b> | <b>Perendimi<br/>sh.a<br/>ALL'000</b> |
|------------------------------------------|---------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|---------------------------------------|
| Dividenda e zakonshme e paguar           | 1,400                           | 200                              |                                |                                       |
| Dividenda preferenciale e paguar         |                                 | 120                              |                                |                                       |
| Fitimi i mbajtur me 1 janar 2017         | 38,700                          | 13,950                           | 8,600                          | 450                                   |
| Aksionet e zakonshme prej €1/ALL1 secila | 25,000                          | 10,000                           | 6,500                          | 1,000                                 |
| Aksionet preferenciale prej €1 secila    |                                 | 4,000                            |                                |                                       |

- ii) Me 1 prill 2009, Veriu sh.a bleu 7,000,000 aksione të zakonshme të Lindja sh.a, duke paguar para dhe emetuar aksione. Fitimi i mbajtur i Lindja sh.a në atë datë ishte €5,250,000. Në po të njejtën datë, Veriu sh.a gjithashtu bleu 400,000 aksione preferenciale të Lindja sh.a në vlerën nominale.

Zëri i mirë në blerje ishte €600,000 prej së cilës €140,000 ishte dëmtuar deri më 31 dhjetor 2016. Nuk ka humbje të tjera të dëmtimit që nga ajo datë. Lindja sh.a nuk ka emetuar aksione të reja që nga data e themelimit.

- iii) Aksionet preferenciale të Lindja sh.a nuk kanë normë fikse të dividendës dhe janë jo-kumulative dhe të pakonvertueshme. Pagesa e dividendave të këtyre aksioneve është në diskrecion të kompanisë.
- iv) Me 31 dhjetor 2016, me qëllim të zgjerimit të operacioneve të saj në Shqipëri, Veriu sh.a bleu 65% të interesit në aksione të ekuitetit të Perendimi sh.a për €3,810,600. Edhe pse Veriu sh.a ka marrë kontrollin e biznesit, Perendimi sh.a-së i është dhënë fuqi autonome të vendimarrjes mbi operacionet e saja ditore
- v) Me 2 janar 2017, Lindja sh.a bleu 70% të aksioneve të zakonshme të Jugu sh.a për €9,212,000, duke paguar para.
- vi) Fitimi prej €100,000 nga shitja e makinerisë në librat e Jugu sh.a rrjedhi nga shitja e makinerisë tek Veriu sh.a me 1 shkurt 2017. Në pikën e shitjes, jeta e mbetur e përdorimit e makinerisë ishte pesë (5) vite. Është politikë e grupit që ta ngarkoj zhvlerësimin e tërë vitit në vitin e blerjes dhe asgjë në vitin e largimit.
- vii) Gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2017, Veriu sh.a shiti mallra tek Lindja sh.a dhe Jugu sh.a për €3,000,000 dhe €100,000 respektivisht. Mallrat janë shitur me një fitim prej 20% në çmimin shitës. Të gjitha mallrat kanë mbetur në depot e Lindja sh.a dhe Jugu sh.a deri me 31 dhjetor 2017.

- viii) Supozohet qe të gjitha shpenzimet dhe fitimet ndodhin njetrajtësisht përgjatë vitit përveç nëse është thënë ndryshe.
- ix) Është politikë e grupit të vlerësoj interesat jo-kontrollues me pjesën e tyre proporcionale të (vlerës së drejtë) të pasurive neto të identifikueshme të filialit.
- x) Normat relevante të kursit të këmbimit ndëçjet Lekut shqiptar dhe Euros janë si në vijim:
- |                                         |                 |
|-----------------------------------------|-----------------|
|                                         | <b>ALL 1: €</b> |
| Data e blerjes së stokeve fillestare    | 2.92            |
| Data e blerjes së stokeve përfundimtare | 2.94            |
| 31 dhjetor 2016                         | 2.90            |
| 31 dhjetor 2017                         | 2.93            |
| Mesatarja për 2017                      | 2.91            |
- xi) Fitimi për vitin në pasqyrat e përkthyer të pozitës financiare të Perendimi sh.a me 31 dhjetor 2017 është përcaktuar të jetë €550,000.

**Kërkohet:**

- a) **Llogarite fitimin ose humbjen në ripërkthimin e zërit të mirë që rrjedh në konsolidim nga blerja e Perendimi sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. (5 pikë)**
- b) **Përkthe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse të Perendimi sh.a në euro për përgaditjen për konsolidim. (7 pikë)**
- c) **Përgadite pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për grupin për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. (18 pikë)**

**Total: 30 pikë**

## Zgjidhja e problemit 1

a) Zëri i mirë nga blerja e Perendimi sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017.

|                                               | AAL'000    | ALL'000      | €'000            |
|-----------------------------------------------|------------|--------------|------------------|
| Konsiderata e transferuar (€3,810,600 ÷ 2.90) |            | 1,314        |                  |
| Minus:                                        |            |              |                  |
| Vlera e drejtë e neto pasurive të blera       |            |              |                  |
| Aksionet e zakonshme                          | 1,000      |              |                  |
| Fitimet e mbajtura                            | <u>450</u> |              |                  |
|                                               | 1,450      |              |                  |
|                                               | × 65%      | <u>942.5</u> |                  |
| Zëri i mirë                                   |            | 371.5 × 2.90 | 1,077.350        |
|                                               |            | × 2.93       | <u>1,088.495</u> |
| Zëri i mirë – fitimi në këmbim                |            |              | 11.145           |

b) Perendimi sh.a

**Pasqyra e përkthyer e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017**

|                               | AAL'000      | AAL'000      | Norma | €'000             | €'000           |
|-------------------------------|--------------|--------------|-------|-------------------|-----------------|
| Shitjet                       |              | 600          | 2.91  |                   | 1,746           |
| Stoqet në fillim              | 200          |              | 2.91  | 582               |                 |
| Blerjet                       | 600          |              | 2.91  | 1,746             |                 |
| Stoqet në fund                | <u>(536)</u> |              | 2.91  | <u>(1,559.76)</u> |                 |
| Kosto e shitjeve              |              | <u>(264)</u> |       |                   | <u>(768.24)</u> |
| Fitimi bruto                  |              | 336          |       |                   | 977.76          |
| Shpenzimet operative          |              | (26)         | 2.91  |                   | (75.66)         |
| Shp. e shitjes & shperndarjes |              | <u>(70)</u>  | 2.91  |                   | <u>(203.70)</u> |
| Fitimi para tatimit           |              | 240          |       |                   | 698.40          |
| Tatimi                        |              | <u>(60)</u>  | 2.91  |                   | <u>(174.60)</u> |
| <b>Fitimi pas tatimit</b>     |              | <b>180</b>   |       |                   | <b>523.80</b>   |

c)

## Veriu sh.a

**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse  
për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017**

|                                                                                | €'000              | €'000              |
|--------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Shitjet (67,000 + 42,000) + 15,000 + 1,746 - 3,000 - 100                       |                    | 122,646            |
| Stoqet në fillim (10,000 + 5,800) + 3,200 + 582                                | 19,582             |                    |
| Blerjet (40,000 + 20,000) + 5,300 + 1,746 - 3,000 - 100                        | 63,946             |                    |
| Stoqet në fund (15,000 + 9,000) + 2,000 + 1,559.76 - 600 - 20                  | <u>(26,939.76)</u> |                    |
| Kosto e shitjeve                                                               |                    | <u>(56,588.24)</u> |
| Fitimi bruto                                                                   |                    | 66,057.76          |
| Shpenzimet operative (8,400 + 9,400) + 2,950 + 75.66 - 20 (zhvl.)              |                    | (20,805.66)        |
| Shp. e shitjes & shperndarjes                                                  |                    | (203.70)           |
| Të hyrat nga dividend preferenciale                                            |                    | -                  |
| Fitimi nga shitja e makinerisë                                                 |                    | <u>-</u>           |
| Fitimi para tatimit                                                            |                    | 45,048.40          |
| Tatimi (5,903 + 3,950) + 1,412 + 174.60                                        |                    | <u>(11,439.60)</u> |
| <b>Fitimi pas tatimit</b>                                                      |                    | <b>33,608.80</b>   |
| <i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</i>                                    |                    |                    |
| Diferencat në këmbim 550 - 523.80                                              |                    | 26.20              |
| Zëri i mirë - fitimi në këmbim                                                 |                    | <u>11.145</u>      |
| <b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>                                     |                    | <b>33,646.145</b>  |
| <i>Fitimi atribuar:</i>                                                        |                    |                    |
| Mbajtësve të ekuitetit të Veriu sh.a                                           |                    | 27,677.89          |
| Interesave jo-kontrollues (L11)                                                |                    | <u>5,930.91</u>    |
|                                                                                |                    | <b>33,608.80</b>   |
| <i>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse atribuar:</i>                           |                    |                    |
| Mbajtësve të ekuitetit të Veriu sh.a $27,677.89 + 11.145 + (26.2 \times 65\%)$ |                    | 27,706.065         |
| Interesave jo-kontrollues $5,930.91 + (26.2 \times 35\%)$                      |                    | <u>5,940.080</u>   |
|                                                                                |                    | <b>33,646.145</b>  |

| <b>L11 Fitimi atribuar te IJK</b> | <b>€'000</b> |   |     | <b>€'000</b>    |
|-----------------------------------|--------------|---|-----|-----------------|
| <i>Lindja sh.a</i>                |              |   |     |                 |
| FPT                               | 11,850       |   |     |                 |
| Dividenda preferenciale           | <u>(120)</u> | × | 90% | 108             |
| FPT për aksionarët e zakonshëm    | 11,730       | × | 30% | <u>3,519</u>    |
|                                   |              |   |     | 3,627           |
| <i>Jugu sh.a</i>                  |              |   |     |                 |
| FPT                               | 4,238        |   |     |                 |
| Fitimi nga shitja e makinerisë    | (100)        |   |     |                 |
| Mbi zhvlerësimi i makinerisë      | <u>20</u>    |   |     |                 |
|                                   | 4,158        | × | 51% | 2,120.58        |
| <i>Perendimi sh.a</i>             |              |   |     |                 |
| FPT                               | 523.80       | × | 35% | <u>183.33</u>   |
|                                   |              |   |     | <b>5,930.91</b> |

## Problemi 2

Një ekstrakt nga draft pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse të Era sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 është paraqitur më poshtë:

|                            | €'000        |
|----------------------------|--------------|
| Të hyrat                   | 1,116        |
| Kosto e shitjeve           | <u>(375)</u> |
| Fitimi bruto               | 741          |
| Të ardhurat nga investimet | 25           |
| Shpenzimet e shpërndarjes  | (110)        |
| Shpenzimet administrative  | <u>(300)</u> |
| Fitimi para tatimit        | 356          |
| Tatimi                     | <u>(89)</u>  |
| <b>Fitimi për vitin</b>    | <b>267</b>   |

Era sh.a është një kompani Shqiptare me disa divizione, dhe që të gjitha raportohen ndarazi dhe janë komponente të dallueshme dhe të mëdhaja të kompanisë. Gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2017, Era sh.a kreu një riorganizim si në vijim:

- Aktivitete e Divizionit Lindor janë zhvendosur tek një fabrike e re në Europen Lindore. Menaxhmenti i këtij divizioni mbetet në Shqipëri.
- Divizioni Perendimor është ndërprerë. Kompania ka vendosur që këtë pjesë të biznesit ta kontraktoj tek një distributor i jashtëm (outsourcing) duke filluar nga 1 janar 2018.

Rezultatet e Divizionit Lindor dhe Perendimor janë paraqitur më poshte, dhe janë përfshirë në shifrat e mësipërme.

|                           | Divizioni Lindor | Divizioni Perendimor |
|---------------------------|------------------|----------------------|
|                           | €'000            | €'000                |
| Të hyrat                  | 73               | 200                  |
| Kosto e shitjeve          | (26)             | (80)                 |
| Shpenzimet e shpërndarjes | (13)             | (5.5)                |
| Shpenzimet administrative | (20)             | (24)                 |
| Shpenzimet e tatimit      | (12)             | (20)                 |

**Kërkohe:**

**(i) Çfarë nënkuptohet me një ‘operacion të ndërprerë’? Vlerëso nëse Divizioni Lindor apo/dhe Divizioni Perendimor i Era sh.a. duhet të trajtohet si një operacion i ndërprerë sipas SNRF 5 Nderprerja e operacioneve dhe pasuritë jo-qarkulluse të mbajtura për shitje. (5 pikë)**

**(ii) Ridrafto ekstraktet nga pasqyra e mësipërme e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për të qenë në pajtueshmëri me SNRF 5 Nderprerja e operacioneve dhe pasuritë jo-qarkulluse të mbajtura për shitje. Trego shënimet e kërkuara sa i përket ndonjë operacioni të ndërprerë. (5 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

(i) Një operacion i ndërprerë është një komponent i një entiteti që ose është shitur/hequr ose është i klasifikuar si i mbajtur për shitje. Për këtë qëllim, një komponent përbëhet nga operacionet dhe rrjedhat e parasë që qartazi mund të dallohen nga pjesa tjetër e entitetit dhe zakonisht përbëjnë një njësi të vetme gjeneruese të parasë apo grup të njësive gjeneruese të parasë. Që të konsiderohet operacion i ndërprerë, operacioni duhet të paraqes një zonë të veçantë gjeografike të operacioneve ose një linjë të madhe të biznesit.

Që të dy divizionet përmbushin përkufizimin e një komponenti pasi që të dy janë raportuar ndarazi. Mbyllja e Divizionit Lindor nuk është një operacion i ndërprerë. Kjo për arsye se nuk është shuarje e një linje të madhe të biznesit pasi që operacionet e saj janë zhvendosur në një lokacion tjetër, e as nuk paraqet mbyllje të operacioneve Shiptare. Divizioni Perendimor paraqet një operacion të ndërprerë, pasi që operacionet e shpërndarjes, një linjë e madhe e biznesit, janë shuar nga brenda kompanisë.

(5 pikë)

(ii) Ekstraktet e rishikuara nga pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

€'000

Operacionet e vazhdueshme

Të hyrat (1,116 – 200) 916

Kosto e shitjeve (375 – 80) (295)

Fitimi bruto 621

Të ardhurat tjera 25

646

Shpenzimet e shpërndarjes (110 – 5.5) (104.5)

Shpenzimet administrative (300 – 24) (276)

Fitimi para tatimit 265.5

Tatimi (89 – 20) (69)

Fitimi për vitin nga operacionet e vazhdueshme 196.5

Operacionet e ndërprera

Fitimi për vitin nga operacionet e ndërprera (shënim 1) 70.5

**Fitimi për vitin 267**

|                                  |             |
|----------------------------------|-------------|
| Shënim 1 operacionet e ndërprera | €'000       |
| Të hyrat                         | 200         |
| Kosto e shitjeve                 | <u>(80)</u> |
| Fitimi bruto                     | 120         |
| Shpenzimet e shpërndarjes        | (5.5)       |
| Shpenzimet administrative        | <u>(24)</u> |
| Fitimi para tatimit              | 90.5        |
| Tatimi                           | <u>(20)</u> |
| <b>Fitimi për vitin</b>          | <b>70.5</b> |

### Problemi 3

Zenit sh.a, është një kompani e listuar në bursë me seli në Mitrovicë, e cila prodhon orendi për zyre për tregun lokal dhe atë të jashtëm. Në vijim është bilanci vertesues i Zenit sh.a me 31 dhjetor 2017

#### Bilanci vertetues me 31 dhjetor 2017

|                                                  | Debi<br>€'000  | Kredi<br>€'000 |
|--------------------------------------------------|----------------|----------------|
| Kapitali aksionar prej €1 secila                 |                | 32,000         |
| Premia e aksioneve                               |                | 18,400         |
| Fitimet e mbajtura (1 janar 2017)                |                | 5,136          |
| 7% nota krediti (emetuar me 1 janar 2017)        |                | 12,000         |
| Llogaritë e pagueshme                            |                | 3,180          |
| Lejimet për borxhet e dyshimta                   |                | 512            |
| Detyrimi i tatimit të shtyrë (me 1 janar 2017)   |                | 672            |
| Zhvlerësimi i akumuluar – fabrika dhe paisjet    |                | 1,700          |
| Zhvlerësimi i akumuluar – ndërtesa               |                | 3,344          |
| Banka                                            | 10,688         |                |
| Llogaritë e arkëtueshme                          | 4,080          |                |
| Stoqet                                           | 3,508          |                |
| Fabrika dhe paisjet                              | 5,336          |                |
| Toka dhe ndërtesat                               | 24,000         |                |
| Pasuritë e patrupëzuara                          | 5,700          |                |
| Investimet                                       | 25,600         |                |
| Shitjet                                          |                | 37,088         |
| Kosto e shitjeve                                 | 18,000         |                |
| Shpenzimet administrative                        | 10,600         |                |
| Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes            | 3,680          |                |
| Interesi i notave të kreditit (vetëm për 6 muaj) | 420            |                |
| Dividenda e paguar                               | 800            |                |
| Tatimi i paguar                                  | 1,620          |                |
|                                                  | <b>114,032</b> | <b>114,032</b> |

#### Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- Stoqet në fund përfshinin disa mallrat të dëmtuara që kushtuan €640,000 dhe pritet që do të shiten për €280,000.
- Toka e cila bartet sipas koston prej €8.8 milion është rivlerësuar në €10 milion. Kompania dëshiron që të kontabilizoj tokën sipas vlerës së drejtë.
- Total investimet ishin €25.6 milion. €20 milion ishte klasifikuar si investim i mbajtur për tregtim me një vlerë të drejtë në fund të vitit prej €26 milion. Saldo e mbetur është klasifikuar si e në dispozicion për shitje dhe vlera e tregut ishte €8 milion.

- iv) Me 1 prill 2017, Zenit sh.a u akordoi dhjetë drejtorëve të saj optionet për të blerë 10,000 aksione të zakonshme me çmim €5 për aksion. Optionet përfitohen menjëherë por drejtorët mund të ushtrojnë te drejtat e tyre deri me 31 mars 2018. Vlera e drejtë e optioneve në datën e akordimit ishte €5 dhe çmimi mesatar i aksioneve gjatë vitit ishte €10. Asnjë nga drejtorët nuk i ka ushtruar optionet e tyre deri me 31 dhjetor 2017. Optionet e aksioneve nuk janë njohur në librat e llogarive.
- v) Shpenzimet e tatimit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 ishin vlerësuar të jenë €1,408,000, përfshirë ndryshimet në detyrimin e tatimit të shtyrë. Neto diferenca e përkohshme e tatueshme me 31 dhjetor 2017 ishte €1,680,000. Norma e tatimit për vitin ishte 25%.
- vi) Detajet e pasurive të patrupëzuara me 1 janar 2017:

|                                 | <b>Kosto</b> | <b>Amortizimi i<br/>akumuluar</b> | <b>Vlera<br/>bartese</b> |
|---------------------------------|--------------|-----------------------------------|--------------------------|
|                                 | <b>€'000</b> | <b>€'000</b>                      | <b>€'000</b>             |
| Kosto e zhvillimit të softuerit | 4,300        | 2,580                             | 1,720                    |
| Patenta                         | 2,600        | -                                 | 2,600                    |
| Kosto e hulumtimi               | 1,380        | -                                 | <u>1,380</u>             |
|                                 |              |                                   | <b>5,700</b>             |

Kosto e zhvillimit të softuerit amortizohet përgjatë pesë (5) viteve.

Patenta është blerë me 1 janar 2016 dhe ka një jetë të pakufishme të përdorimit. Megjithatë me 1 korrik 2017, për shkak të konkurrencës së ashpër nga një konkurent i ri, vlera e patentës ra në €2,250,000 me një jetë të vlerësuar të përdorimit prej 3 viteve.

Kostot e hulumtimit kanë të bëjnë me kostot që janë shkaktuar gjatë vitit në zhvillimin e dizajnit të ri, i cili ishte i pasukseshëm.

- vii) Injoro tatimin e shtyrë për rivlerësimin e pronës dhe optionet e aksioneve

#### **Kërkohet:**

**Në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të raportimit Financiar, përgaditi pasqyrat financiare në vijim për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 për Zenit sh.a:**

- a) Pasqyrën e fitimit ose humbjës dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse (8 pikë)
- b) Pasqyrën e Pozitës Financiare (12 pikë)

**Shënimet e pasqyrave financiare dhe fitimi për aksion nuk kërkohen.**

**(Total: 20 pikë)**

## 3.

## Zenit sh.a

## Pasqyra e fitimit ose humbjës dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

|                                                           | €'000        | €'000           |
|-----------------------------------------------------------|--------------|-----------------|
| Shitjet                                                   |              | 37,088          |
| Kosto e shitjeve                                          |              | <u>(18,360)</u> |
| Fitimi bruto                                              |              | 18,728          |
| Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes                     |              | (3,680)         |
| Shpenzimet administrative                                 |              | (14,065)        |
| Kosto financiare                                          |              | (840)           |
| Ndryshimet në VD të investimeve (26,000 - 20,000)         |              | <u>6,000</u>    |
| Fitimi para tatimit                                       |              | 6,143           |
| Tatimi:                                                   |              |                 |
| Shpenzimet e tatimit aktual (1,408 + 252)                 | 1,660        |                 |
| Shpenzimet e tatimit të shtyrë                            | <u>(252)</u> | <u>(1,408)</u>  |
| <b>Fitimi për periudhën</b>                               |              | <b>4,735</b>    |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse                       |              |                 |
| Zërat që nuk do të riklasifikohen tëk fitimi ose humbja:- |              |                 |
| Teprica në rivlerësimin e tokës                           | 1,200        |                 |
| Teprica në pasuritë financiare në dispozicion për shitje  | <u>2,400</u> | <u>3,600</u>    |
| <b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>                |              | <b>8,335</b>    |

## Zenit sh.a

## Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2017

|                                                 | €             |
|-------------------------------------------------|---------------|
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>                 |               |
| Prona, fabrika dhe paisjet (L17)                | 25,492        |
| Të patrupëzuara: Kostot e zhvillimit & Patentat | 2,735         |
| Investimet (25,600 + 6,000 + 2,400)             | 34,000        |
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese::</i>                |               |
| Stoqet (3,508 - 360)                            | 3,148         |
| Llogaritë e arkëtueshme (9,080 - 512)           | 3,568         |
| Paraja në bankë                                 | <u>10,688</u> |
|                                                 | <b>79,631</b> |
| <i>Ekuiteti:</i>                                |               |
| Kapitali aksionar                               | 32,000        |
| Rezervat                                        | 9,071         |
| Rezervat tjera                                  | 22,500        |
| <i>Detyrimet afatgjata:</i>                     |               |
| 7% Nota krediti                                 | 12,000        |
| Detyrim i tatimit të shtyrë                     | 420           |

*Detyrimet afatshkurtëra:*

|                       |               |
|-----------------------|---------------|
| Tatimi i pagueshëm    | 40            |
| Llogaritë e pagueshme | 3,180         |
| Interesi akrual       | <u>420</u>    |
|                       | <b>79,631</b> |

**Llogaritjet:**

|                                  |               |
|----------------------------------|---------------|
| <b>(L11) Kosto e shitjeve</b>    | <b>€'000</b>  |
| Sipas B/V                        | 18,000        |
| (+) Stoqet e dëmtuara(640 - 280) | <u>360</u>    |
|                                  | <b>18,360</b> |

|                                        |               |
|----------------------------------------|---------------|
| <b>(L12) Shpenzimet administrative</b> | <b>€'000</b>  |
| Sipas B/V                              | 10,600        |
| (+) Opcionet e aksioneve               | 500           |
| Amortizimi – kosto e zhvillimit        | 860           |
| - patenat                              | 375           |
| Patenta e shlyer                       | 350           |
| Kosto e hulumtimit                     | <u>1,380</u>  |
|                                        | <b>14,065</b> |

**(L13) Shpenzimet dhe rezervat e opcioneve të aksioneve (pagesat e bazuara në aksione)**

|                               | <b>Shpenzimet</b> | <b>Rezervat e Opcioneve të Aksioneve</b> |
|-------------------------------|-------------------|------------------------------------------|
|                               | <b>€</b>          | <b>€</b>                                 |
| 1 prill 2017 10 x 10,000 x €5 | 500,000           | 500,000                                  |

**(L14) Tatimi i shtyrë**

|                                           |                  |
|-------------------------------------------|------------------|
|                                           | <b>€</b>         |
| Saldo me 1 janar 2017                     | 672,000          |
| Levizjet në tatimin e shtyrë              | <u>(252,000)</u> |
| Saldo me 31 dhjetor 2017 (1,680,00 x 25%) | 420,000          |

**(L15) Tatimi**

|                       |                  |
|-----------------------|------------------|
|                       | <b>€</b>         |
| Tatimi për vitin      | 1,408,000        |
| (-) Ndryshimet në TSH | 252,000          |
|                       | 1,660.000        |
| (-) Tatimi i paguar   | <u>1,620,000</u> |
|                       | 40,000           |

**(L16) Investimet në dispozicion për shitje**

|                       |                  |
|-----------------------|------------------|
|                       | €                |
| Kosto                 | 5,600,000        |
| VD                    | <u>8,000,000</u> |
| Teprica në rivlerësim | 2,400,000        |

**(L17) Prona, fabrika dhe paisjet**

|                            | Kosto/Rivl. | Zhvl. akm | Vlera bartëse |
|----------------------------|-------------|-----------|---------------|
| <b>Fabrika dhe paisjet</b> | 5,336       | (1,700)   | 3,636         |
| Toka                       | 10,000      |           | 10,000        |
| Ndërtesa (24,000 – 8,800)  | 15,200      | 3,344     | <u>11,856</u> |
|                            |             |           | 25,492        |

**(L18) Pasuritë e patrupëzuara**

|                                             |                |
|---------------------------------------------|----------------|
| Kostot e zhvillimit:                        | €              |
| Kosto                                       | 4,300          |
| (-) Amortizimi: sal në/fillim 2,580         |                |
| Vitit aktual <u>860</u>                     |                |
|                                             | <u>(3,440)</u> |
| Vlera bartese me 31/12/2017                 | 860            |
| <br>Patenta                                 |                |
| Kosto                                       | 2,600          |
| (-) Rënia në vlerë <u>350</u>               |                |
|                                             | 2,250          |
| (-)Amortizimi (2,250/3 x 6/12) <u>(375)</u> |                |
| Vlera bartese me 31/12/2017                 | 1,875          |

**(L19) Rezervat tjera**

|                                 |        |
|---------------------------------|--------|
|                                 | €      |
| Premia e aksioneve              | 18,400 |
| Rezerva e rivlerësimit          | 1,200  |
| NDSH                            | 2,400  |
| Opcionet e aksioneve <u>500</u> |        |
|                                 | 22,500 |

#### Problemi 4

a) Busulla sh.a është një kompani publike në Iliri dhe kishte në pronësi një ndërtesë më të cilën ka marrë borxh për të financuar operacionet e saj. Busulla sh.a e shiti ndërtesën për €5 milion tek një kompani financuese me 1 janar 2017 kur vlera bartëse e ndërtesës ishte €3.5 milion. Megjithatë, ndërtesa e njëjtë ishte marrë menjehere me lizing nga kompania financuese për një periudhë 20 vjeçare, që konsiderohet se është ekuivalent me pjesën më të madhe të jetës ekonomike të kësaj pasurie. Qirate për këtë periudhë janë €441,000 në vit të pagueshme në fund të vitit. Interesi i nënkuptuar në lizing është 7%. Vlera e tanishme e pagesave minimale të garantuara të lizingut është e barabartë me arkëtimet nga shitja

#### Kërkohet:

Trego se si Busulla sh.a duhet ta kontabilizoj transaksionin e mësipërm për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 në pajtim me SNK 17 Lizingjet. Trego ekstraktet përkatëse të pasqyrës së fitimit ose humbjes, pasqyrës së rrjedhës së parasë dhe pasqyrës së pozitës financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. (5 pikë)

b) Informatat në vijim kanë të bëjnë me skemen e pensioneve të Kompasi sh.a për vitin e përfunduar me 30 dhjetor 2017:

|                                                              | €000    |
|--------------------------------------------------------------|---------|
| Pasuritë e planit me 1 janar 2017                            | 96,000  |
| Obligimet e përfitimeve të paracaktuara me 1 janar 2017      | 100,000 |
| Kostot e shërbimit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 | 8,000   |
| Norma e skontimit me 1 janar 2017                            | 10%     |
| Humbja nga ri-matja në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 | 4,000   |
| Kostot e shërbimeve të kaluara 1 janar 2017                  | 6,000   |

Kostot e pensioneve nuk janë kontabilizuar në total të ardhurat gjithëpërfshirëse pasi që kontabilisti i kompanisë nuk është i kualifikuar ende dhe nuk ka njohuri të mjaftueshme për kërkesat e SNK 19 Përfitimet e punonjësve.

#### Kërkohet:

Trego se si ransaksioni i mësipërm duhet të kontabilizohet sipas kërkesave të SNK 19 përfitimet e punonjësve duke përfshirë ekstraktet përkatëse të pasqyrave financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. (5 pikë)

c) Poli sh.a është një kompani që operon në Iliri dhe i jep kredi klientëve dhe i financon këto kredi duke emetuar obligacione në treg. Detyrimi financiar është përcaktuar sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Obligacionet kishin rritje në vlerën e drejtë prej €100 milion në vitin deri me 31 dhjetor 2017 prej të cilave €5 milion kanë të bëjnë me rënien e rrezikut kreditor të Poli sh.a. Drejtorët e Poli sh.a kanë kontaktuar firmen tuaj të konsulencës për këshillën tuaj se si të kontabilizohet kjo rritje e vlerës.

**Kërkohet:**

**Diskuto, me llogaritje të përshtatshme sipas nevojës, trajtimin në kontabilitet të transaksionit të mësipërm në pasqyrat financiare të Poli sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. (5 pikë)**

d) Stratosfera sh.a bleu një biznes të shërbimeve të taksisë me 1 janar 2017 për €230,000. Vlera e pasurive të biznesit në atë datë bazuar në çmimin neto të shitjes ishte si në vijim:

|                          | €000        |
|--------------------------|-------------|
| Vetura                   | 120         |
| Pasuritë e patrupëzuara  | 30          |
| Të arkëtueshmet tregtare | 10          |
| Paraja                   | 50          |
| Të pagueshmet tregtare   | <u>(20)</u> |
|                          | <b>190</b>  |

Me 1 shkurt 2017, biznesit të shërbimit të taksisë iu vodhen tri (3) vetura. Çmimi neto i shitjes së këtyre veturave ishte €30,000 dhe për shkak të mos-shpalosjeve të disa rreziqeve tek kompania e sigurimeve, biznesi nuk u siguria. Si rezultat i kësaj ngjarje, Stratosfera sh.a dëshiron që të njohë një humbje nga dëmtimi prej €45,000 duke përfshirë edhe humbjen nga vjedhja e veturave për shkak të rënies së vlerës së njësisë gjeneruese të parasë që iu kishin vjedhur veturat, pra biznesin e shërbimeve të taksisë. Me 1 mars 2017, një kompani rivale e shërbimeve të taksisë filloi biznesin në zonën e njejtë. Parashihet që të hyrat e biznesit të Stratosfera sh.a do të zvogëlohen për 25% që do të shpie në rënie të vlerës së tanishme në përdorim të biznesit e cila është llogaritur të jetë €150,000. Vlera neto e shitjes së licencës së taksisë ka rënë në €25,000 si rezultat i operatorit të taksisë. Vlera neto e shitjes e pasurive tjera ka mbetur e njejtë si me 1 janar 2017.

**Kërkohet:**

**Rekomando se si Stratosfera sh.a duhet t'i kontabilizoj transaksionet/ngjarjet e mësipërme në pasqyrat e saj financiare në pajtim me SNK 36 Dëmtimi i pasurive. (Total: 20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 4

4

a) Lizingu në këtë rast është shitje dhe marrje me qera dhe ndërtesa është për pjesen më të madhe të jetës ekonomike dhe vlera e tanishme e pagesave minimale të lizingut është e barabartë me vlerën e drejtë të pasurisë nën lizing. Andaj, lizingu duhet të trajtohet si lizing financiar.

Ndërtesa çkontabilizohet sipas vlerës bartëse dhe më pas kontabilizohet sipas vlerës së drejtë dhe çfardo fitimi nga shitja, në këtë rast €1.5 milion (€5m – €3.5m) shtyhet përgjate kohëzgjatjes së lizingut. Ndërtesa zhvlerësohet përgjate jetës ekonomike apo kohëzgjatjes së lizingut cilado që është më e shkurtër, pra 20 vite. Kontabiliteti i lizingut financiar rezulton me një detyrim të krijuar, kosto financiare të përllogaritur me normën e nënkuptuar në lizing, në këtë rast 7%, dhe pagesa për zvogëlimin e detyrimit të lizingut për të llogaritur saldon në fund të vitit. Hyrjet e dyfishta lidhur me këtë janë si në vijim:

|                                                                       | D €000 | K €000 |
|-----------------------------------------------------------------------|--------|--------|
| Paraja                                                                | 5,000  |        |
| Ndërtesa                                                              |        | 3,500  |
| Fitimi i shtyrë                                                       |        | 1,500  |
| Pasuria do të regjistrohet menjehere dhe kontabilizohet si në vijim : |        |        |
|                                                                       | D €000 | K €000 |
| Pasuria nën lizing financiar                                          | 5,000  |        |
| Obligimet ndaj lizingut financiar                                     |        | 5,000  |
| Zhvlerësimi i pasurisë në lizing financiar                            | 250    |        |
| Pasuria nën lizing financiar                                          |        | 250    |
| Fitimi i shtyrë                                                       | 75     |        |
| Pasqyra e fitimit ose humbjes                                         |        | 75     |
| Pasqyra e fitimit ose humbjes (interesi i pag. per lizing fin,)       | 350    |        |
| Interesi i përllogaritur për lizingun financiar                       |        | 350    |

Zhvlerësimi = €5, 000, 000/20 vite = €250,000 në vit

Fitimi i shtyrë i njohur për vit = €1, 500, 000/20 vite = €75,000

Tabela e amortizimit të obligimit ndaj lizingut financiar

| Viti | Detyrimi në fillim<br>€000 | NEI@7%<br>€000 | Pagesat<br>€000 | Detyrimi në fund<br>€000 |
|------|----------------------------|----------------|-----------------|--------------------------|
| 1    | 5,000                      | 350.00         | (441)           | 4,909.00                 |
| 2    | 4,909                      | 343.63         | (441)           | 4,811.63                 |

Ekstraktet e pasqyrave financiare për vitin e parë të kontratës së lizingut financiar

**Ekstrakt i pasqyrës së pozitës financiare në fund të vitit të parë**

**€000**

*Pasuritë jo-qarkulluese:*

|                              |              |
|------------------------------|--------------|
| Pasuria nën lizing financiar | 5,000        |
| Zhvlerësimi                  | <u>(250)</u> |
|                              | 4,750        |

*Detyrimet afatgjata:*

|                                   |          |
|-----------------------------------|----------|
| Obligimet ndaj lizingut financiar | 4,811.63 |
| Fitimi i shtyrë                   | 1,425.00 |

*Detyrimet afatshkurtëra:*

|                                                      |        |
|------------------------------------------------------|--------|
| Obligimet ndaj lizingut financiar (4,909 – 4,811.63) | 97.37  |
| Interesi i përlllogaritur                            | 350.00 |

**Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 (ekstrakt)**

**€000**

|                               |       |
|-------------------------------|-------|
| Zhvlerësimi                   | (250) |
| Interesi i lizingut financiar | (350) |
| Fitimi i shtyrë (fituar)      | 75    |

**Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 (ekstrakt)**

**€000**

*Rrjedhat e parasë nga aktivitete financiare*

|                              |       |
|------------------------------|-------|
| Pagesat e lizingut financiar | (441) |
|------------------------------|-------|

**b) Kostot e pensionit të njohura për vitin do të ishin:**

**€000**

|                                                                       |              |
|-----------------------------------------------------------------------|--------------|
| Kostot e shërbimeve aktuale                                           | 8,000        |
| Neto kostot e interesit (10% of €100m – €96m)                         | 400          |
| Kostot e shërbimeve të kaluara                                        | <u>6,000</u> |
| Neto kostot e shërbimeve të njohura ne fitim ose humbje               | 14,400       |
| Rimatjet në TTGJ                                                      | <u>4,000</u> |
| Neto kostot e vitit të njohura në total të ardhurat gjithëpërfshirëse | 18,400       |

SNK 19 në fakt nuk e specifikon se ku kostot e shërbimit dhe neto të interesit duhet të paraqiten. Si rezultat, është e pranueshme të përfshihen kostot neto të interesit në kosto financiare.

SNK 19 thotë që kostot e shërbimeve të kaluara duhet të njihen menjëherë dhe kostot e shërbimeve të kaluara duhet të përfshihen në obligimet e përfitimeve të përcaktuara me 1 janar 2017. Andaj nuk ka nevojë të llogarisim kosto të interesit në koston e shërbimeve të kaluara.

Ekstraktet e pasqyrave financiare:

|                                                        |             |
|--------------------------------------------------------|-------------|
| <i>Pasqyra e fitimit ose humbjes</i>                   | <b>€000</b> |
| Neto kostot e shërbimit të njohura në fitim ose humbje | (14,400)    |
| TTGJ                                                   |             |
| Rimatjet në TTGJ                                       | (4,000)     |

c)

SNRF 9 kërkon që përfitimet dhe humbjet nga detyrimet financiare të përcaktuara sipas vlerës së drejtë nëpërjet fitimit ose humbjes siç është rasti tek Poli sh.a të ndahen në shumat e ndryshimit në vlerën e drejtë që i atribuohen rrezikut kreditor të detyrimit, e cila paraqitet tek të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse, dhe pjesa e mbetur e ndryshimeve në vlerën e drejtë e cila paraqitet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

SNRF 9 lejon njohjen e tërë shumës së ndryshimit të vlerës së drejtë në pasqyrën e fitimit ose humbjes vetëm nëse njohja e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimit në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse do të rriste mospërputhjen kontabël.

Kjo përcaktohet në njohjen fillestare dhe nuk rivlerësohet. Shumat e paraqitura në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse nuk transferohen më pas në fitim ose humbje, dhe entiteti mund të transferoj vetëm fitimin apo humbjen kumulative brenda ekuitetit. Si rezultat, Poli sh.a duhet të ngarkoj €5 milion në TTGJ dhe €95 milion në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

**d) Stratosfera sh.a** duhet të njohë humbjen nga dëmtimi si në vijim:

Kur humbja nga dëmtimi identifikohet, duhet të njihet si shpenzim menjëhere në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kur humbja nga dëmtimi ka të bëjë me një grup të pasurive, zakonisht, humbja nga dëmtimi duhet të alokohet se pari ndaj zërit të mirë që i është caktuar njesisë gjeneruese të parasë.

*Me 1 shkurt 2017*

|                                            | <b>1 janar 2017</b> | <b>Humbja nga dëmtimi</b> | <b>01 shkurt 2017</b> |
|--------------------------------------------|---------------------|---------------------------|-----------------------|
|                                            | <b>€'000</b>        | <b>€'000</b>              | <b>€'000</b>          |
| Zëri i mirë                                | 40                  | (15)                      | 25                    |
| Pasuritë e patrupëzuara (Licenca e taksit) | 30                  |                           | 30                    |
| Veturat                                    | 120                 | (30)                      | 90                    |
| Neto pasuritë qarkulluese                  | <u>40</u>           | <u>0</u>                  | <u>40</u>             |
|                                            | 230                 | (45)                      | 185                   |

Humbja nga dëmtimi prej €30,000 së pari njihet për mjetet motorike të vjedhura dhe pjesa e mbetur (€15,000) i atribuohet zërit të mirë.

*Me 1 mars 2017*

|                           | <b>1 shkurt 2017</b> | <b>Humbja nga dëmtimi</b> | <b>01 mars 2017</b> |
|---------------------------|----------------------|---------------------------|---------------------|
|                           | <b>€000</b>          | <b>€000</b>               | <b>€000</b>         |
| Zëri i mirë               | 25                   | (25)                      | -                   |
| Pasuritë e patrupëzuara   | 30                   | (5)                       | 25                  |
| Veturat                   | 90                   | (0)                       | 90                  |
| Neto pasuritë qarkulluese | <u>40</u>            | <u>0</u>                  | <u>40</u>           |
|                           | 185                  | (30)                      | 155                 |

## Problemi 5

a) Mali sh.a është një entitet i specializuar në importimin e shumë artikujve jo-ushqimor dhe shitjen e tyre tek shitesit me pakicë. Lumi është drejtor ekzekutiv i Mali sh.a dhe themelues dhe ka në pronësi 40% të aksioneve të ekuitetit të Mali sh.a-së:

- i) Klienti me i madh i Mali sh.a-së, Fusha sh.a merr pjesë në 35% të shitjeve të Mali sh.a. Fusha sh.a vetëm sa ka përfunduar negociatat me Mali sh.a për një zbritje speciale prej 5% në të gjitha shitjet.
- ii) Gjatë periudhës së kontabilitetit, Lumi bleu një pronë nga Mali sh.a për €500,000. Mali sh.a më heret ka deklaruar se prona është e tepërt dhe nuk i nevojitet dhe e ka vlerësuar në €750,000.
- iii) Djali i Lumit, Deti është drejtor në një institucion financiar, Ujëvara sh.a. Gjatë periudhës kontabël Ujëvara sh.a. i dha Mali sh.a-së €2 milion kredi të pasiguruar me një normë të favorshme të interesit.

### Kërkohet:

**Shpjego, me arsye, deri në cilën shkallë secili nga transaksionet e mësipërme duhet të klasifikohet dhe shpaloset në pasqim me SNK 24 Shpalosjet e palëve të ndërlidhura në pasqyrat financiare të Mali sh.a-së për periudhën.** (5 pikë)

b) Relievi sh.a planifikon që të përmirësoj procesin e saj të prodhimit dhe drejtorët bësojnë se një përmirësim teknologjik është e vetmja mënyrë që të mbeten konkurrues në këto kohë. Kompania operon nga një pronë e marrë me lizing dhe kushtet e lizingut janë dakorduar ashtu që të maksimizohen përfitimet tatimore. Për çudi pasqyrat financiare nuk tregojnë ndonjë pasuri me lizing apo detyrim ndaj lizingut deri më tani.

Një kontabilist financiar i ri i është bashkangjitur Relievi sh.a-së pak pas përfundimit të vitit financiar me 31 korrik 2017 dhe është aktualisht duke rishikuar pasqyrat financiare për t'i përgaditur për auditimin e ardhshëm dhe për të filluar përgaditjen e aplikacionin për kredi për të financuar teknologjinë e re.

Kontabilisti financiar beson që lizingu që ka të bëjë me tokën dhe ndërtesat duhet të trajtohet si një lizing financiar por drejtori financiar nuk pajtohet asesi. Drejtori financiar nuk dëshiron të njohë lizingun në pasqyrat financiare dhe për këtë dëshiron që të vazhdoj ta trajtoj si lizing operativ. Drejtori financiar beson që lizingu nuk i përmbush kriteret për një lizing financiar, dhe është bërë e qartë nga drejtori financiar se paraqitja e lizingut si lizing financiar mund të ndikojë negativisht në aplikimin për kredi.

### Kërkohet:

**Diskuto çështjet etike dhe profesionale me të cilat ballafaqohet kontabilisti financiar në transaksionin e mësipërm.** (5 pikë)

c) Një nga çështjet aktuale në kotabilitet është koncepti i raportimit social dhe mbi mjedisin. Ka shumë që mendojnë se konceptit të raportimit social dhe mbi mjedisin duhet ti jepet rëndësi dhe nëse është e mundur, të rregullohet me ligj dhe të bëhet i detyrueshëm për të gjitha entitetet e listuara në bursë.

**Kërkohet:**

i) Shpjego natyrën e raportimit social dhe mbi mjedisin? (2 pikë)

ii) Diskuto rëndësinë e raportimeve sociale dhe mbi mjedisin për përdoruesit e pasqyrave financiare. (3 pikë)

d) Karakteristikat kualitative të përkatësisë, paraqitjes me besnikëri dhe krahasueshmërisë të identifikuar në Kornizën e BSNK-së për përgaditjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare (Korniza) janë disa prej attributeve që e bëjnë informatën financiare të dobishme për përdorues të ndryshëm të pasqyrave financiare.

**Kërkohet:**

Diskuto konceptin e përkatësisë, paraqitjes me besnikëri dhe krahasueshmërisë dhe se si e bëjnë informatën financiare të dobishme. (5 pikë)

**Totali 20 pikë**

## Zgjidhja e problemit 5

5.

a) Sipas SNK 24 Shpalosjet e Palëve të Ndërlidhura, një klient me të cilin entiteti ka transaksione biznesore me vëllim të madh nuk është palë e ndërlidhur vetëm për shkak të varësisë ekonomike.

Fusha sh.a nuk është palë e ndërlidhur dhe zbritja e negociuar nuk ka nevojë të shpaloset.

Një palë është e ndërlidhur me një entitet nëse ka një interes në entitet i cili i jep ndikim domethënës mbi entitetin. Si anëtar themelues dhe aksionar i madh duke pasur 40% të ekuitetit në pronësi, Lumi është në gjendje të ushroj ndikim domethënës dhe është palë e ndërlidhur me Mali sh.a. Lumi është gjithashtu një palë e ndërlidhur pasi që është president i Mali sh.a. Ai është anëtar i personelit kyç të menaxhmentit të Mali sh.a. Shitja e pronës për €500,000 duhet të shpaloset, së bashku me vlerësimin e saj si një transaksion me një palë të ndërlidhur.

Financuesit nuk janë palë e ndërlidhur vetëm për shkak të raportit të tyre me entitetin. Por, nëse një palë është anëtar i afërm i familjes (individ i kategorizuar si palë e ndërlidhur) atëherë edhe ata janë palë e ndërlidhur. Pasi që Deti është djali i Lumit dhe Lumi është palë e ndërlidhur atëherë edhe Deti është palë e ndërlidhur. Kredia nga Ujëvara sh.a duhet të shpaloset së bashku me detajet e Detit dhe përfshirjen e tij në këtë aranzhim.

**b)** Një lizing klasifikohet si lizing financiar nëse i transferon në mënyrë substanciale të gjitha rreziqet dhe përfitimet të lidhura me pronësinë. Të gjitha lizingjet tjera klasifikohen si lizingje operative dhe klasifikimi bëhet në fillim të lizingut.

Se a është një lizing financiar apo operativ varet në substancën e transaksionit e jo formën ligjore. Andaj, në shumë rrethana, klasifikimi i lizingut mund të jetë subjektiv. Në rastin e tokës, kjo është subjektive pasi që titulli i pronësisë nuk do t'i kalojë lizingmarrësit në fund të marrëveshjes por lizingu mundet që akoma të klasifikohet si lizing financiar pasi që vlera e tanishme e vlerës së mbetur të tokës është e papërfillshme dhe rreziqet dhe përfitimet janë transferuar tek lizingmarrësi.

Pra, duket që në shikim të parë ka një dallim në opinionet profesionale, të cilat mund të zgjidhen nga kontrolluesi financiar duke kërkuar këshillë.

Nëse veçoritë e lizingut duket se përmbushin Kriteret e SNK 17 Lizingjet për tu klasifikuar si një lizing financiar dhe trajtimi i përdorur është pjesë e strategjisë për të nën-vlerësuar detyrimet e entitetit me qëllim të marrjes së kredisë, atëherë krijohet një dilemë etike.

Kontabilistët profesionist janë në gjendje të gjykojnë, duke aplikuar aftësitë e tyre dhe arritjen e vendimeve në bazë të informative në situata në të cilat publiku i gjërë nuk mundet. Gjykimet e bëra nga kontabilistët profesionist duhet të jenë të pavarura dhe të mos ndikohen nga presionet e biznesit. Kodi i etikës për kontabilistët profesionist është shumë i rëndësishëm sepse i cakton kufijtë jashtë të cilit kontabilistët nuk duhet të qëndrojnë. Drejtori financiar nuk duhet ta vë kontabilistin financiar në presion të madh me qëllim që të ndikojë tek vendimi i tij. Nëse kontabilisti financiar është i bindur se lizingut është financiar, atëherë shpalosja e këtij fakti

duhet të bëhet tek autoritete e brendshme të qeverisjes. Kontabilisti financiar do ta ketë diturinë që veprimet e tij ishin etike.

c)

*a. Raportimi social dhe mbi mjedisin*

Raportimi social dhe mbi mjedisin është matja dhe raportimi i informatave që kanë të bëjnë me impaktin e një biznesi dhe aktiviteteve të tij në shoqërinë. Është shpalosja e informatave në raportet vjetore të publikuara ose në një raport të veçantë, të efekteve që operacionet e biznesit kanë në mjedisin natyror. Me fjale të tjera, është përmbledhja dhe komunikimi i të dhënave – financiare, kuantitative dhe/ose kualitative – për bashkëveprimin e organizatës me shoqërinë.

*b. Rëndësia e raportimeve sociale dhe mbi mjedisin për përdoruesit e pasqyrave financiare.*

Shtylla e raportimit social është pranimi eksplisit që çdo organizatë ka në një mori të palëve me interes – ata të cilët janë të influencuar nga dhe/ose, influencojnë organizatën. Përveç aksionarve dhe pjesëmarrësve tjerë financiar, palë të tjera më të rëndësishme me interes janë zakonisht punonjësit, komuniteti lokal, klientët, furnitorët, mjedisi dhe qeveria. Nga këndvështrimi i shoqërisë, secili nga këta palë me interes kanë të drejta, përveç gjërave të tjera, në informata për aktivitetet e organizatës – pa marrë parasysh nëse organizata pranon të njohë të drejtat e tyre. Nga këndvështrimi i organizatës, ajo ka një mori të palëve me interes që duhet ti menaxhoj dhe interesat e të cilëve duhet ti balancoj nëse duhet të mbetet ndërmarrje e sukseshme.

d)

**(i) Përkatësia**

Informata e ka cilësinë e përkatësisë kur mund të indikoj, në kohë, në marrjen e vendimeve ekonomike nga përdoruesi. Ndhmon të vlerësoj ngjarjet, në të kaluarën, në të tashmen dhe në të ardhmen duke konfirmuar apo ndoshta duke korigjuar vlerësimet e mëparme apo ngjarjet ekonomike. Ka shumë mënyra të interpretimit dhe aplikimit të konceptit të përkatësisë, për shembull, vetëm informata materiale konsiderohet përkatëse pasi që, sipas përkufizimit, informata është materiale vetëm nëse largimi apo keqdeklarimi i saj mund të ndikoj tek përdoruesit. Edhe një debat i zakonshëm lidhur me përkatësinë është nëse informata e vlerës aktuale është më përkatëse se ajo e kostos. Një theksim interesant i përkatësisë në Kornizë është që informata përkatëse ndihmon në aftësinë parashikuese të pasqyrave financiare.

Kjo nuk do të thotë që pasqyrat financiare duhet të jenë parashikuese në kuptim të parashikimit të vlerave, por që informata (e së kaluarës) duhet të prezantohet në atë mënyrë që tu ndihmoj përdoruesve të vlerësojnë aftësinë e një entiteti që të përfitoj nga mundësitë dhe të reagoj ndaj situatave të pafavorshme. Një shembull i mirë i kësaj është prezantimi ndarazi i operacioneve të ndërpera në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Nga kjo përdoruesit do të mundën që më mirë të vlerësojnë pjesët e entitetit që do të gjenerojnë fitimet e ardhshme (operacionet e vazhdueshme)

dhe përdoruesit mund të gjykojnë meritat e ndërprerjes p.sh entiteti ka shitur një pjesë profitabile të biznesit (gjë që mund të shpie në pyetjen pse), ose entiteti ka vepruar për të shkurtuar efektet negative të një operacioni që ka shkaktuar humbje.

## **(ii) Paraqitja me besnikëri**

Korniza thotë që informata të jetë e dobishme duhet të jetë e besueshme. Kualiteti i besueshmërisë është përshkruar si të qenit e lirë nga gabimet materiale (e saktë) dhe një paraqitje me besnikëri e asaj që ka për qëllim ta portretizoj (p.sh. paqyrat financiare janë paraqitje me besnikëri e transaksioneve të entitetit). Mund të ketë raste kur forma ligjore e një transaksioni mund të jetë e përpiluar në atë mënyrë që të fsheh realitetin ekonomik të një transaksioni. Synim i paraqitjes me besnikëri është që transaksioni duhet të kotabilizohet sipas substances së tij (p.sh. qëllimi komercial apo realiteti ekonomik) e jo formes së tyre ligjore. Që të paraqitet me besnikëri, informata duhet të jetë neutrale (e lirë nga paragjykimet). Informata me paragjykime tenton që të ndikoj tek përdoruesit (ndoshta që të arrihet tek një vendim i paracaktuar) nga mënyra se si është paraqitur. Dihet që pasqyrat financiare nuk mund të jenë absolutisht të sakta për shkak të paqartësive të pashmangshme që kanë të bëjnë me përgaditjen e tyre. Një shembull tipik do të ishte vlerësimi i jetës së përdorimit ekonomik të pasurive jo-qarkulluese. Kjo adresohet nga përdorimi i maturisë që është ushtrimi i një doze kujdesi në çështjet që kanë paqartësi. Megjithatë matura nuk mund të përdoret që në mënyrë të qëllimshme që të nënvlerësohen fitimet ose krijimin e provizioneve të teperta (kjo do të shkelte parimin e neutralitetit). Informata e besueshme duhet të jetë e plotë, lënia jashtë e informatës (që duhet të raportohet) sigurisht që do të ç'orientonte përdoruesit.

## **(iii) Krahasueshmëria**

Krahasueshmëria është fundamentale për vlerësimin e performances së një entiteti. Përdoruesit do të krahasojnë rezultatet e një entiteti përgjatë kohës dhe gjithashtu me entitet të ngjajshme. Kjo është arsyeja kryesore se pse pasqyrat financiare përmbajnë shumat korresponduese të vitit paraprak. Krahasueshmëria rritet nga përdorimi (dhe shpalosja) e politikave konsistente të kontabilitetit ashtu që përdoruesit të mund të konfirmojnë që informata krahasuese (për llogaritjen e trendeve) është e krahasueshme dhe shpalosja e politikave të kontabilitetit së paku i informon përdoruesit nëse entitetet tjera përdorin politika të ndryshme. Andaj, krahasueshmëria nuk duhet të pengoj praktikën e përmirësuar të kontabilitetit (zakonisht nëpërmjet Standardeve të reja); dihet se ka raste kur është e nevojshme të adoptohet një politikë e re e kontabilitetit nëse kjo mund të rrisë përkatësinë dhe besueshmërinë.

